Korrigjim gabimi material

Në vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 187, datë 25.11.2019, "Mbi licencimin e shoqërisë "MP-HEC" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Niçë", me kapacitet të instaluar 2270 kw, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 171, datë 16.12.2019, bëhet ndryshimi në dispozitivin e këtij vendimi, si më poshtë vijon:

Në pikën 1, germa "a" bëhet:

a) Shoqëria "MP-HEC" sh.p.k. të depozitojë në ERE, pas nënshkrimit, kontratën shtesë të koncesionit, në vijim të miratimit nga MIE të projektit të zbatimit të përmirësuar të HEC "Niçë".

Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

3. Shoqëria "MP-HEC" sh.p.k., të depozitojë në ERE dokumentacionin e kërkuar para fillimit të operimit të veprës.

Pika 3 bëhet 4 dhe pika 4 bëhet pika 5.